

# STATUSI I QEVERISJES LOKALE

BASHKIA Krujë



## PROJEKTI STAR 2

Projekti STAR 2 po asiston 61 bashkitë e reja, Ministrin për Çështjet Vendore dhe Agjencinë për Zbatimin e Reformës Territoriale në procesin e konsolidimit të Reformës Administrative Territoriale dhe të thellimit të procesit të decentralizimit.

Do të shtrihet në të 61 bashkitë dhe njësitë administrative.

Drejtimit kryesore të asistencës teknike përfshijnë:

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për komunitetet lokale, nëpërmjet zhvillimit të konceptit të shërbimeve me një ndalesë “One Stop Shop”, modernizimin e arkivave nëpërmjet sistemit të menaxhimit të dokumentacionit dhe dixhitalizimit.
- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të administratës së bashkive nëpërmjet trajnimeve.
- Përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit në vendim marrje.



## Asistenca teknike e dedikuar për 61 bashkitë e reja nëpërmjet projektit STAR 2 mbështetet nga:

- Bashkimi Evropian (BE),
- Qeveria Italiane,
- Qeveria Suedeze(SIDA),
- Qeveria Zvicerane (SDC),
- Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USAID)
- PNUD/UNDP
- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore



Vlerësimi i Situatës së Qeverisjes Vendore sipas këtij formati, po zhvillohet për herë të parë në Shqipëri

Dhjetor 2016 – Mars 2017 dhe do të përsëritet në fund të vitit 2019.

Ky proces ka për qëllim:

1. Vlerësimin e Situatës së Qeverisjes Vendore nga këndvështrimi i bashkive dhe i qytetarëve;
2. Identifikimin e mundësive dhe sfidave të qeverisjes në cdo bashki;
3. Diskutimin e politikave të qeverisjes vendore në mënyrë të informuar.

Gjetjet e vlerësimit do të përdoren gjithashtu për të përditësuar ndërhyrjet e projektit STAR 2.



## Vlerësimi i Situatës së Qeverisjes Vendore

- Metodologjia e Vlerësimit të Situatës së Qeverisjes Vendore bazohet në modele ekzistuese të zbatuara nga UNDP dhe organizata të tjera në nivel ndërkombëtar.
- Në përshtatje të modeleve ekzistuese me Kontekstin shqiptar dhe me kontribut nga ekspertë lokalë, instrumentat komunikues që u përdoren dhe aktorët e përfshirë në këtë projekt përmbledhen:
  - Takime/Diskutime me Kryetarin e Bashkisë, Kryetarin e Këshillit Bashkiak, drejtuesit e Drejtorive të Financës dhe Buxhetit, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Punëve dhe Shërbimeve Publike dhe Kordinatorin përgjegjës për Informimin dhe Njoftimet Publike;
  - Diskutime me grupe të fokusuara në Bashki me përbërje të përfaqësuesve të Drejtorive kryesore dhe administratorëve të njësive administrative;
  - Diskutime me grupe të fokusuara me qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile;
  - Anketa me banorët e Bashkisë në lidhje me kënaqësinë ndaj shërbimeve publike dhe perceptimet mbi qeverisjen vendore;

Shkodër; Vau i Dejës; Pukë; Malësi e Madhe; Fushë Arrëz; Kukës, Tropojë; Has; Lezhë;Kurbini; Mirditë; Dibër; Bulqizë; Mat; Klos; Krujë; Vorë; Durrës; Shijak e Kamëz.



# STATUSI I QEVERISJES VENDORE


Raporti strukturohet në 4 kapituj:

Metodat e përdorura për mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për bashkinë.




1. Përshkrim të përgjithshëm të Bashkisë së Kruje;
2. Pasqyrë e situatës së qeverisjes vendore në Kruje duke e vlerësuar në bazë të indikatorëve të katër dimensioneve të rëndësishme: a) efektivitetit dhe efijencës; b) transparencës dhe sundimit të ligjit; c) llogaridhënies; ) pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar.
3. Përfundimet kryesore të këtij hulumtimi, duke nxjerrë në dukje anët më të forta dhe më të dobëta të bashkisë.



## Shpërndarja e Pyetësorve sipas njësive administrative



## Shpërndarja e Pyetësorve sipas njësive administrative






## Shpërndarja e Pyetësorve sipas njësive administrative

- Përbërja e kampionit të intervistuar ka qenë 51 % meshkuj dhe 49 % femra.
- Numri më i madh i pyetësorëve është shpërndarë dhe plotësuar në njësinë administrative e Fushë Krujës me 32% ndërsa numri më të vogël u shpërnda në njësinë administrative Cudhi 3 % e pyetësorëve. Vihet re një shpërndarje pothuajse e njëjtë mes tre kategorive të moshave që kanë pranuar dhe plotësuar formularët e anketimit.




## Shpërndarja e Pyetësorëve sipas njësive administrative


### Edukimi



### Punësimi



### Të ardhurat mujore



Bashkia	Qendra Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Krujë	Krujë	<b>Krujë</b>	Barkanesh , Picërragë, Brret
		<b>Fushë - Krujë</b>	Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2
		<b>Bubq</b>	Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë – Madhe, Mazhë – Vogël, Mallkuç, Murqinë
		<b>Nikël</b>	Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë
		<b>Thumanë</b>	Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër
		<b>Cudhi</b>	Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi – Kant, Kroi Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë

Njësia administrative	Përfituesit e ndihmës ekonomike (NE)		Fondi gjithsej i NE	Numri i popullsisë përfituese (frymë) të pagesës së paaftësisë		Fondi gjithsej i pagesës së paaftësisë
	Numri për frymë	Numri i familjeve		Numri i personave me aftësi të kufizuar	Numri i kujdestarëve	
Krujë		74	279000	299	31	3984193
Fushë - Krujë		219	1073440	444	54	5816760
Bubq		6	35640	123	15	2262130
Nikël		77	395240	199	21	2364650
Thumanë		63	338560	329	28	3644180
Cudhi		124	682760	111	10	1306330
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>563</b>	<b>2804640</b>	<b>1505</b>	<b>159</b>	<b>19378243</b>

Njësitë administrative	Kopshtet			Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Numri i shkollave nëntëvjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
Krujë	6	348	23	6	1270	85	1	676	33
Fushë - Krujë	6	641	25	6	3039	161	1	1199	58
Bubq	5	122	5	2	628	64	1	178	8
Nikël	5	138	5	5	628	64	1	101	8
Thumanë	5	220	7	5	1295	87	2	238	15
Cudhi	3	46	3	6	230	34			
<b>Totali</b>	<b>30</b>	<b>1515</b>	<b>68</b>	<b>30</b>	<b>7090</b>	<b>495</b>	<b>6</b>	<b>2392</b>	<b>122</b>



Njësitë administrative	Numri i qendrave shëndetësore	Numri i ambulancave	Mjekë të përgjithshëm dhe infermierë
Krujë			
Fushë - Krujë			
Bubq			
Nikël			
Thumanë			
Cudhi			
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>



Njësitë administrative	Numri i Bizneseve			Numri i Fermave Gjithsej	Sipërfaqja e tokës bujqësore (në m <sup>2</sup> )
	Biznes vogël	Biznes i madh	Gjithsej		
Krujë					4,147
Fushë - Krujë					11,008
Bubq					11,399
Nikël					8,332
Thumanë					18,992
Cudhi					3,225
<b>Totali</b>			0	0	57,103



Njësitë administrative	Numri i punonjësve		
	Meshkuj	Femra	Totali
Krujë	78	52	130
Fushë - Krujë	59	16	75
Bubq	25	6	31
Nikël	26	3	29
Thumanë	43	22	65
Cudhi	9	1	10
<b>Totali</b>	<b>240</b>	<b>100</b>	<b>340</b>



**Tabela 1: Përmbledhja e vlerësimit të situatës së qeverisjes vendore sipas kuadrit analitik**

Vlerësimi I Përgjithshëm I Situatës së Qeverisjes Vendore	54
Efektiviteti dhe Efiçenca	53
Transparenca dhe Sundimi i Ligjit	55
Llogaridhënia	59
Pjesëmarrja dhe Angazhimi i Qytetarëve	48

## EFEKTIVITETI DHE EFIÇENCA

- Situata e qeverisjes vendore në perceptimin e qytetarëve dhe punonjësve të bashkisë paraqitet në nivel mbi mesataren në Bashkinë e Krujës. Në total, të katër komponentët e funksionimit të qeverisjes lokale vlerësohen me 54 pikë. Dimensioni më problematike është ai i pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar i cili është vlerësuar me vetëm 48 pikë.
- Dimensioni që është vlerësuar me pikët më të larta është ai i llogaridhënies me 59 pikë. Llogaridhënia në këtë vlerësim nënkupton aftësinë e bashkisë për të shpjeguar dhe raportuar veprimet e saj tek qytetarët, Këshilli Bashkiak si edhe për të trajtuar ankesat e këtyre të fundit.




## EFEKTIVITETI DHE EFIÇENCA

- Termi efektivitet për qeverinë lidhet me arritjen e cilësisë së kërkuar për shërbimet publike, lidhet me arritjen e pavarësisë ndaj presioneve politike, lidhet me hartimin dhe zbatimin e politikave dhe me besueshmërinë e angazhimit të qeverisë ndaj këtyre politikave. Ndërsa termi efiçencë lidhet me arritjen e rezultatit të kërkuar me një sasi minimale të burimeve, të kohës dhe të kostos.
- Ky dimension përfaqësohet nga vizioni dhe planet gjithëpërfshirëse, menaxhimi financiar, vendimmarrja e informuar, koordinimi dhe bashkëpunimi si dhe nga kënaqësia me shërbimet publike. Ky kriter është vlerësuar me 53 pikë nga pjesëmarrësit e fokus grupeve.



# Shërbimet publike me prioritet

Figure 1. Ekzistenca e shërbimeve publike dhe niveli i kënaqësisë së qytetarëve me to





## Shërbimet publike me prioritet

- Vihet re proçesi për marrjen e shërbimeve administrative bashkiake si leje, licensa, çertifikata etj është vlerësuar pothuajse mesatar nga qytetarët e anketuar CRC me 49 pikë, ndërkohë që 9 pikë më shumë i ka dhënë kësaj nën-çështje FG i komunitetit, të cilët e kanë vlerësuar mesatarisht me 58 pikë. Por, unanimitisht me 100 pikë është vlerësuar akses i barabartë i femrave me meshkujt në shërbimet administrative.
- Nëse shikojmë të listuara shërbimet e bashkisë Krujë dhe vlerësimin e qytetarëve në lidhje me egzistencën e tyre, shikojmë se si më problematiket na paraqiten strehimi social, veprimtaritë dhe hapësirat sportive si dhe ato të objekteve kulturore dhe natyrore. Parë tabelën si vijon më poshtë, vëmë re se edhe niveli I kënaqësisë për këto shërbime është më relativisht I ulët, në krahasim me shërbimet e tjera të ofruara.



## TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

- Dimensioni i transparencës dhe sundimit të ligjit ofron një vlerësim të qasjes që ofron bashkia ndaj çdo informacioni mbi vendime apo procese vendimmarrëse dhe të kuadrit ligjor që rregullon këtë proces. Nën këtë dimension përfshihet edhe nën-kriteri i nivelit të korrupsionit si një element i lidhur drejtpërsëdrejti me sundimin e ligjit. Në total kriteri i transparencës & sundimit të ligjit vlerësohet me 55 pikë, vlerësim ky mesatar I dhënë për këtë kriter.
- Në lidhje me informacionin nga bashkia për qytetarët rreth projekteve lokale, aktiviteteve, buxhetit të bashkisë apo shërbimeve të ofruara, në total kemi një vlerësim mbi mesataren me 62 pikë, me vlerësime të ndara specifikisht: 68 pikë të dhëna nga FG I bashkisë e karakterizojnë këtë nën-kriter si një nivel mbi mesataren për informimin dhe pothuajse njëspk mendon edhe FG I komunitetit të cilët e kanë vlerësuar me 65 pikë. Ndërkohë që vlerësimin më të ulët e japin të anketuarit CRC me 53 pikë, nivel edhe ky që sillet rreth mesatarit.




## TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

- Përsa i përket transparencës së procedurave administrative nga bashkia, kemi ndryshim në perceptimin e të dyja fokus grupeve. Punonjësit e bashkisë, pjesëmarrës në fokus grup e vlerësojnë si një nivel të mirë transparencën duke i akorduar 67 pikë, ndërkohë që pjesëmarrësit në fokus grupin e komunitetit, kanë një vlerësim më të ulët, që shkon tek mesatarja me 58 pikë.
- Egzistenca online e bashkisë Krujë me një faqe të veten dhe përditësimin e informacionit është vlerësuar relativisht me pikë të larta nga të dy fokus grupet pjesëmarrëse në anketim. Respektivisht me 83 dhe 81 pikë, duke e vlerësuar si faqe online përgjithësisht të përditësuar.

## TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Figure 1. Niveli i transparencës së bashkisë Krujë sipas qytetarëve






## TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

- Nga grafiku bie në sy që të tre grupmoshat e kanë vlerësuar pothuajse njësoj nivelin e transparencës së bashkisë Krujë, duke l akorduar nga 47 – 49 pikë. Vihet re që është grupmosha e tretë që e vlerëson më pak.
- Në lidhje me dijeninë e qytetarëve mbi faqen online të bashkisë Krujë, kemi një përceptim prej 46 % të personave të anketuar që janë në dijeni mbi egzistencën e faqes online. Janë grupmosha e tretë ata të cilët kanë dojeninë më të ulët dhe që janë përgjigjur me jo me një vlerësim prej 53 %.




# TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Figure 1. Niveli i nformimit nga bashkia në lidhje me aktivitetet dhe shërbimet e saj




# TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Figure 1. Dijenia e qytetarëve mbi faqen online të Bashkisë



# TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

**Figure 1. Vlerësimi mbi informimin publik (ndërgjegjësimin) nga bashkia mbi ligjet dhe rregulloret lokale**




*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*



# KORRUPSIONI


Figure 1. Niveli i perceptimit të korrupsionit për qeverisjen bashkiake



Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve

# KORRUPSIONI


**Figure 1. Baza ku qytetarët bazojnë më së shumti vlerësimin e tyre për korrupsionin**



*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*

# TRANSPARENCA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Figure 1. Kontakti me zyrat e bashkisë në 12 muajt e fundit dhe niveli i kënaqësisë me secilën prej tyre



Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve



## LLOGARIDHËNIA


- Llogaridhënia, si një prej shtyllave përbërëse të vlerësimit të funksionimit të qeverisjes lokale mat aftësinë e bashkisë për t'u përgjigjur para aktorëve përgjegjës, Këshill Bashkiak, qytetarë, qeveri qendrore, mbi veprimet apo mosveprimet e bashkisë si edhe për të trajtuar ankesa të ndryshme nga ana e qytetarëve. Në këtë seksion përfshihen mekanizmat e kontrollit, komunikimi dhe reagimi si edhe dhënia e përgjigjeve nga ana e administratës lokale. Ky kriter ka marrë gjithsej 59 pikë në total.
- Nën-kriteri i mekanizmave të kontrollit kërkon të analizojë ekzistencën ose jo të organizmave të cilat kontrollojnë, mbikqyrin dhe marrin masa për administratën vendore. Në total ky nënkriter është vlerësuar mesatarisht me 52 pikë.
- Pyetjes nëse egzistojnë forume të hapura ku OSHC-të mund të angazhohen së bashku me autoritetet lokale në procesin e planifikimit dhe buxhetimit, fokus grupi i përbërë nga punonjësit e bashkisë mendon se ka pak forume me pak akses, duke e vlerësuar me vetëm 28 pikë, ndërkohë që qytetarët në përbërje të fokus grupit të komunitetit mendojnë se egzistojnë disa forume të tilla me akses mesatar duke e vlerësuar me 46 pikë.





# LLOGARIDHËNIA

**Figure 1. Efektiviteti i bashkisë në trajtimin e ankesave**




*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*



# LLOGARIDHËNIA


Figure 1. Parashtrimi i ankesës ose jo nga qytetarët që kanë pasur arsye për t'u ankuar



Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve

# LLOGARIDHËNIA

Figure 1. Përgjigjshmëria e bashkisë ndaj ankesave të qytetarëve



*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*

# LLOGARIDHËNIA

- Niveli i reagimit të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve, bizneseve dhe aktorëve të tjerë ka marrë vlerësimin më të ulët të këtij kriteri, ka marrë vlerësimin më të lartë në lidhje me kriterin e llogaridhënies. Si nën-kriter është vlerësuar në total me 77 pikë, vlerësim ky relativisht i mirë, krahasuar me nën-nivelet e tjera të këtij kriteri.
- 70 % vlerësohet pozitivisht përgjegjshmëria e bashkisë ndaj ankesave të qytetarëve, që kanë patur arsye për tu ankuar dhe që e kanë parashtuar si ankesë.



# PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI I QYTETARËVE

- Dimensioni i pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar nënkupton përfshirjen e gjithë qytetarëve në planifikimin e zhvillimit vendor me qëllim alokimin e duhur të burimeve në ndërhyrjet e administratës vendore. Këtu vlerësohet kuadri institucional për menaxhimin e pjesëmarrjes qytetare, përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes, si dhe nivelin e tyre të pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar. Ky kriter është vlerësuar ulët me vetëm 48 pikësh në total.




# PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI I QYTETARËVE

- 36 pikë në total (një vlerësim I përlogaritur nga të dy fokus grupet) është vlerësuar mundësia e OSHC-ve në gjendje për të lobuar dhe advokuar në mënyrë efektive me qëllim ndikimin në planifikimin dhe vendimmarrjen e administratës vendore, ku bie në sy që FG I komunitetit jep 41 pikë, përkundër 30 pikëve të FG të bashkisë. Një vlerësim I cili përkthehet në pak është vlerësuar mundësia e OSHC-ve në gjendje për të lobuar dhe advokuar në mënyrë efektive.
- Në lidhje me angazhimin e të rinjve në vendimmarrje, përsëri të dy fokus grupet kanë pothuajse të njëjtën linjë mendimi, duke I dhënë një mesatare prej vetëm 50 pikësh. Pra, ndonjëherë, administrata vendore I angazhon të rinjtë në vendimmarrje, vlerësim ky I arritur nga 47 pikë të akorduara nga punonjësit e bashkisë pjesëmarrës në fokus grup dhe nga 54 pikë që I ka akorduar fokus grupi I komunitetit



**Figure 1. Ndërveprimi me administratën vendore dhe shprehja publikisht e mendimit për çështje lokale, politike, sociale dhe mjedisore**




*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*

# VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Të pyetur në përgjithësi për cilësinë e jetës në qytetin e tyre pjesa më e madhe (42%) e të anketuarve e cilësojnë atë unanimisht (meshkuj dhe femra) si mesatare. 36 % e tyre e konsiderojnë cilësinë e jetës të mirë dhe vetëm 2 % e të anketuarve e cilësojnë nivelin e jetesës në Krujë si të mirë. Janë 3 % e meshkujve që e kanë dhënë këtë vlerësim (cilësi jetese e mirë) ndërkohë që femrat e vlerësojnë me 0 këtë kriter.

**Figure 1. Niveli i cilësisë së jetës në Bashkinë e Krujës sipas banorëve**



*Burimi: Karta e Raportimit të Qytetarëve*



# VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

- Ajo çfarë bie në sy nga rishikimi i situatës vendore në bashkinë Krujë dhe njësitë e tjera administrative është vlerësimi mesatar në pothuajse të gjitha kategoritë e përfshira në anketim me fokus grupet si dhe me qytetarët e anketës CRC.
- Të gjitha kriteret: Efektiviteti & Efiçenca, Transparenca & Sundimi i Ligjit, Llogaridhënia si dhe Pjesëmarrja e qytetarëve, në vlerësimin total kanë arritur në nivelin mesatar. Shumë pak nën-kritere kanë marrë vlerësim pothuajse pozitiv dhe paralelisht, shumë nën-kritere të tjera për mendimin e të përfshirëve në anketim, janë vlerësuar dobët.
- Kënaqësia me shërbimet publike në bashkinë Krujë së bashku me nën-kriteret që e plotësojnë është vlerësuar mirë nga qytetarët e kësaj bashkie. Vlen për tu përmendur egzistenca e shërbimeve publike si dhe barazia gjinore në aksesin e këtyre shërbimeve që është vlerësuar në nivele shumë të mira.
- Të njëjtin vlerësim të mirë, ata (pjesëmarrësit në anketim) ja atribuojnë qytetarëve aktivë në ndërveprimin për çështjet lokale.



# PËRFUNDIME

- Sa i përket trasparencës & sundimit të ligjiti cili në terësi është vlerësuar mesatarisht, egzistenca dhe përditësimi i faqes online të bashkisë Krujë ka marrë vlerësim të mirë dhe pozitiv, krahasuar me vlerësimin mesatar të transparencës apo qasjes në informacion. Nëse ndalojmë tek sundimi i ligjit vëmë re se qytetarët kanë dhënë vlerësim të dobët dhe aspak pozitiv në lidhje me aktivitetet edukuese rreth kuadrit ligjor të organizuar nga bashkia.
- Megjithëse kriteri i korrupsionit në terësi është vlerësuar në nivele mesatare, vëmë re se perceptimi i qytetarëve për këtë fenomen është shumë i ulët, vlerësuar unanimisht dobët.
- Pjesëmarrja e qytetarëve në kuadrin institucional, në përfshirjen e palëve të interesuara, si dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve në terësi, përpos vlerësimeve mesatare, ka shumë nën-kritere për të cilat të anketuarit kanë rezervat dhe dyshimet e tyre. Ata vlerësojnë si shumë të dobëta iniciativat e lindura nga strukturat qytetare, njësoj edhe për sistemin e buxhetimit me pjesëmarrje, ndikimin e OSHC-ve në vendimmarrje, angazhimin e grave në vendimmarrje, pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhjet e bashkisë si dhe përfshirjen e tyre në monitorim dhe vlerësim.



# PËRFUNDIME

- Në seksionin e llogaridhënies vëmë re se qytetarët kanë dyshime dhe vlerësime të dobëta në lidhje me forumet e hapura për angazhimin e OSHC-ve si pjesë e mekanizmave të kontrollit, ndjekur me po të njëjtin vlerësim të dobët për monitorimin e këtyre mekanizmave nga këshillat komunitarë. Nëse shikojmë me vëmendje nën-kriterin e komunikimit dhe reagimit, bie në sy i njëjti vlerësim i dobët për mekanizmat për ndarjen e mendimeve.
- Në vendimmarrjen e informuar, megjithë vlerësimet mesatare të pothuajse të gjitha nën-kritereve përbërëse vëmë re se sistemi GIS, është vlerësuar si pikë e dobët dhe pakënaqësitë janë shprehur në vlerësimin e ulët që i është atribuar.
- Përgjigjshmëria e administratës vendore arrin të ketë vlerësimin më të lartë si një prej kritereve më të mira atribuar nga qytetarët dhe pjesëmarrësit në të dy fokus grupet.



# Faleminderit!

